



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 125/13
Prishtinë, më 09.09.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziri dhe Sevdije Lama.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Imba Rudaku dhe Arbëreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj-Ministër i Financave, Qerkin Berisha-MF, Enver Peci-Kryesues i Këshillit Gjyqësor, Vehbi Behluli nga KGJK, Skender Komoni, Shkëlzen Llluka, Avni Jashari nga AKP, Rejhane Zylfijaj, Ramadan Islami nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Anëtarësimin e Kosovës në BZHKE;**
- 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-102;**
- 5. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012;**
- 6. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012;**
- 7. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit vlerësues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së;**
- 8. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit

Hykmete Bajrami konstatoj se procesverbalet përmbajnë fjalime të pakuptueshme dhe nuk besoj se jemi të pakuptueshëm sa që të mos regjistrohen diskutimet tona, stafi duhet të ketë kujdes gjatë përgatitjes së

procesit. Poashtu konsideroj se duhet të jenë më efikas në mënyrë që çdo herë të jetë procesverbali i mbledhjes së kaluar për miratim në mbledhjen e radhës.

Kryetarja theksoj se kemi bërë përpjekje që procesverbalet të jenë pas çdo mbledhjeje të komisionit kësaj radhe për shkak të rishikimit të buxhetit dhe mbledhjeve të përditshme, nuk është arritur të përgaditen dhe miratohen me kohë ato.

Albana Fetoshi propozoj që para miratimit procesverbali të na dërgohet në mënyrë elektronike.

Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura të Komisionit, me vërejtjet e paraqitura.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Anëtarësimin e Kosovës në BZHKE

Kryetarja sqaroj se Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim dhe në pajtim me nenin 18 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 10 të Ligjit për Marrëveshje Ndërkombëtare ka proceduar këtë marrëveshje në Kuvend. Projektligjit përmban të gjitha çështjet që duhet t'i ketë një projektligj, është përshkruar edhe qëllimi se pse ka ardhur, njëkohësisht është bërë vlerësimi i ndikimit financiar të projektligjit në ratifikimin e marrëveshjes.

Besim Beqaj theksoj se Banka për Zhvillim merret me projektet që kanë për synim aspektet sociale të vendeve anëtare të cilat janë pjesë e kësaj banke. Me dt.14.06.2013 është bërë një rezolutë e cila i hap rrugë Kosovës për t'u anëtarësuar në këtë bankë dhe një ndër parakushtet është që marrëveshja themeluese për Bankën e Këshillit të Evropës në Kosovë të kalon përmes Kuvendit. Pas miratimit të këtij ligji nga ana e Kuvendit do të vazhdohet me procedura të tjera. Vlen të theksohet se ka një implikim financiar ku duhet të paguhet shumat e anëtarësisë. Kemi paraparë që nëse kjo zhvillohet të bëhet nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Duke pas parasysh se Kosovës i duhen projektet që kanë për qëllim përmirësimin qoftë të infrastrukturës fizike apo natyrës që i mbulon kjo bankë. Ka qenë mjaftë e vështirë që të hapim rrugë të tilla dhe mendoj se është një lobim i suksesshëm i Qeverisë së Kosovës që ne të bëhemi pjesë e kësaj banke.

Hykmete Bajrami kërkoj sqarim për titullin e Ligjit ku paraqiten diferencat në mes të versionit në gjuhën shqipe dhe angleze. Në gjuhën angleze nuk thuhet marrëveshja themeluese por vetëm ratifikimi i neneve të marrëveshjes për bankë, kurse titulli i ligjit në gjuhën shqipe lenë përshtypjen se me këtë ligj po bëjmë themelimin e një Banke për Zhvillim të Këshillit. Poashtu gjatë leximit të marrëveshjes kostoja financiare është 2,866,000.00€, një kosto tjetër është një letër premtuese e pagueshme në vlerë 6,559,000.00€.

Për shumën 2,866,000.00 € shkruan se do të paguhet sapo marrëveshja të ratifikohet kurse pjesa tjetër i bie si një çek i pagueshëm. A ka buxheti i Kosovës mjete buxhetore për këtë kosto?

Besim Beqaj sqaroj se titulli është Projektligji për Ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, pra nuk ka të bëjë me themelimin të bankës.

Qerkin Berisha sqaroj se nëse shikohet brenda projektligjit është në rregull në të dy versionet. Marrëveshja është themeluar para disa viteve kurse ne po e ratifikojmë atë, pra nuk mund të ndryshohet titulli i kohës kur është themeluar.

Hykmete Bajrami konstatoj se në gjuhën angleze nuk përmendet fjala themeluese.

Besim Beqaj sqaroj se ndonjëherë përkthimi i fjalimeve tona mund të dal me gabime të caktuara, mendoj se ne esencë nuk ndryshon asgjë sepse nenet për të cilat ne po i ratifikojmë kanë të bëjnë me themelimin e Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës. Në nivel të përkthimeve mund të bëjmë adaptime të natyrës së caktuar. Kurse sa i përket kostos financiare pjesa që është marrë për obligim do të jetë e buxhetuar ndërsa kjo është garancion bankar dhe si i tillë domosdoshmërisht nuk është mjet i cili mund të jetë efektiv menjëherë.

Hykmete Bajrami pyet se a është e buxhetuar për këtë vit shuma 2,866,000.00 €?

Besim Beqaj sqaroj se për këtë vit është e buxhetuar pjesa që ne do të marrim për obligim.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Projektligjin për Ratifikimin e Neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Anëtarësimin e Kosovës në BZHKE.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-102

Kryetarja sqaroj se qëllimi kryesor për të cilin ka ardhur ndryshimi i Projektligjit është zgjatja e mandatit të Bordit të Pavarur për shqyrtim të ankesave, pasi që numri i madh i ankesave të cilat ende nuk janë zgjedhur. Me ligjin i cili është miratuar vitin e kaluar është paraparë që zgjatja e mandatit të jetë deri më 31.12.2013, por për shkak të pamundësisë së kryerjes së të gjitha lëndëve është propozuar të shtyhet deri më dt. 31.12.2014. Në përmbajtjen e ligjit janë paraparë edhe disa ndryshime, është larguar kufizimi i qarkullimit vjetor prej 50,000.00€ si parakusht për mbajtjen e librave dhe regjistrimeve nga ana e biznesit, poashtu është propozuar që obligimi i biznesit për mbajtjen e regjistrimit të librave për qarkullim vjetor mbi nivelin e pragut të regjistrimit kur tatimpaguesit duhet të regjistrohen për TVSH sipas ligjit për tatimit mbi vlerën e shtuar. Poashtu është propozuar që të largohet dhe ndëshkimi administrativ prej 1,000.00€ për mospërdorimin e pajisjeve elektronike fiskale, mosregjistrimin e transaksioneve të bëra gjatë aktivitetit ekonomik dhe kjo është harmonizuar me Kodin Penal të Kosovës.

Besim Beqaj njoftoi se edhe pse Bordi ka intensifikuar punën nuk ka mundësi që të përfundohen të gjitha. Ideja është që të bëhet zgjatja e mandatit të Bordit aktual deri më 31.12.2014 në mënyrë që të përmbillen të gjitha këto ankesa. Ndërsa të gjitha lëndet e reja të cilat vijnë duhet të shkojnë në Divizionin Fiskal të Gjykatës Themelore. Poashtu ka gjëra teknike që kanë përmirësuar ligjin qoftë tek plotësimi dhe implementimi i dispozitave ndëshkimore pastaj edhe mjetet juridike tek tatimpaguesit që tentojnë ta rrisin intensitetin lidhur me funksionimin e ligjit.

Albana Fetoshi kërkoj sqarim për nenin 2, në pjesën ku thuhet se në tërë tekstin e ligjit bazik fjala Ministria e Ekonomisë dhe Financave zëvendësohet me fjalën Ministria përkatëse për financa. Poashtu Ministri i Ekonomisë dhe Financave zëvendësohet me fjalën Ministri përkatës i financave. Dëshiroj të kuptoj se kujt i drejtohet kur thotë Ministri përkatës i financave? Për çka është menduar kur është shkruar ashtu?

Besim Beqaj sqaroi se strukturat organizative të Qeverisë ka qenë Ministria për Ekonomi dhe Financa e cila tani është Ministri e Financave. Ideja Ministër përkatës i financave është sepse mund të paraqiten ndryshime në të ardhmen, Ministria sërish mund të quhet Ministria e Ekonomisë.

Kryetarja theksoi se në ligje nuk bëhet Ministri përkatës i financave por kur paraqiten obligime bëhet Ministri i Financave.

Sali Asllanaj konstatoi se numri i madh i ankesave që e ka Bordi për rishqyrtim dhe zgjidhja fleksibile që kemi dhënë do të mundësojë që ata të jenë të interesuar që mos ti ndërprejnë kontratat. Objektivisht nëse do ti ishin zgjedhur lëndet do të kishte përfunduar ligji. Konsideroj se edhe pas një viti do të kërkohet që të zgjatet mandati i tyre. Kërkoj të gjejmë zgjidhje të cilat e detyrojnë Bordin e rishqyrtimit të ankesave të përfundojnë detyrat e tyre.

Hykmete Bajrami theksoi se vitin e kaluar i është zgjat mandati këtij Bordi duke vendosur një target brenda afatit për të zgjedhur numrin e lëndëve. Mendoj se nga Ministria e Financave na nevojiten numri i lëndëve të cilat kanë mbetur të pazgjidhura dhe të vendosim një restriksion në ligj që Bordi aktual shqyrtimin e ankesave ta përfundojë në afatin e caktuar. Shumica e neneve të ligjit janë gabime gramatikore, gjuhësore, konsideroj se duhet inkurajuar administrata për të punuar para se ligjet të aprovohen në Kuvend. Poashtu u theksua se është heq ndëshkimi në vlerë 1,000.00€ për bizneset të cilat nuk pesodojnë arka fiskale, kërkoj sqarim nga Ministri se cila është logjika e këtij plotësim ndryshimi. Gjithashtu pse është bërë zbritja e ndëshkimit nga vlera 250.00€ në 125.00€?

Naser Osmani konstatoi se nuk janë bërë kalkulime të sakta kur e kemi dhënë kohën kur ligji duhet të hyj në fuqi sepse komisioni ska arritur që brenda kësaj kohe të përfundojë të gjitha lëndet. Nga informata që kam mandati i ka skaduar tre anëtarëve të Bordit duke përfshirë edhe kryetarin. Procedura për shtyrje apo emërim të tyre janë tjera sepse kalon një procedurë me rekomandim të Qeverisë në votim në Parlament. Duke marrë parasysh faktin se ne po iu japin kohë për të përfunduar lëndet, dhe me dispozita kalimtare të i vazhdohet Komisionit në tërësi në mënyrë që ti shmangemi kësaj procedure sepse kërkon kohë.

Kryetarja sqaroi nenin 20 pika 2 thotë të hiqet pjesa që ka të bëjë me ndëshkim administrativ në vlerën prej 1,000.00€ por zëvendësohet me tekstin përndjekjes për shkelje penale pas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Latif Gashi vlerësoi se propozimi i deputetit Osmani është më i miri i mundshëm, pra të formojmë një grup punues, duke caktuar saktësisht mandatin për kohën e cila i nevojitet.

Qerkin Berisha sqaroi se vitin e kaluar janë zgjedhur mbi 1000 lëndë, edhe pse është dyfishuar numri i lëndëve nga viti paraprak sërish kanë mbetur edhe 1200 lëndë të tjera të pazgjidhura që nënkupton se nevojitet aq kohë për t'u zgjidh deri në tetor të vitit 2014. Megjithatë kemi propozuar një afat më të gjatë deri në fundvit për shkak të arsyeshmërisë si dhe tek neni 25, anëtarëve të cilëve i'u skadon afati me dt. 23 shtator dhe me 31 dhjetor 2014 të i'u vazhdohet mandati.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë :

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-102.

5. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012

Kryetarja theksoj se nga raporti financiar i KGJK-së vërejmë se buxheti është shpenzuar 89.90 %, tek kategoria *Paga dhe Mëditje* është realizuar 95.58 %, tek *Mallrat dhe Shërbimet* është realizuar 90.38%, kategoria e *Shpenzimeve Komunale* 82.99%, kategoria për *Subvencione dhe Transfere* 50.97 % si dhe kategoria për *Shpenzime Kapitale* është realizuar 63.59%. Gjatë analizës së raporti shohim se janë bërë disa lëvizje në vendime të Qeverisë, poashtu ka pasur edhe të hyra në këtë institucion.

Enver Peci fillimisht njoftoj se donacioni i cili i është ndarë KGJK-së ka qenë në vlerë 18,250,942.00 € kurse me të hyra ka qenë 19,464,842.00€, gjithsej 1929 pozita prej tyre 399 gjyqtar dhe 1530 pozita administrative. Gjatë vitit 2012 buxheti është realizuar 89.90 % është shpenzuar në nivel të përafërt të planifikimit. Sa i përket investimeve kapitale për shkak të procedurave të Komisionit i cili nuk ka pranuar punën nuk kemi arritur të realizojmë një projekt i cili do të rriste shumën e kapitalit. Vlen të theksohet mosplotësimi i pozitave, përkatësisht 66 gjyqtar dhe 97 pozita administrative. Në vitin 2013 ka hy në fuqi Ligji për KGJK dhe kemi bërë një riorganizim total të rrjetit të gjykatave dhe stafit administrativ gjë që paraqet ndikim fakti se 30 pozita për gjyqtar nuk kemi pasur mundësi të i plotësojmë për shkak se minoritet përkatësisht ai serb nuk ka pasur kandidatë të cilët dëshirojnë të kyqen në sistemin e KGJK. Poashtu Raporti i Auditorit Gjeneral ka rezultuar me aplikim të mirë, buxheti ka qenë në kuadër të kornizave ligjore dhe është shpenzuar sipas parametrave. Sa i përket rritjeve për shumat e kompensimit të avokatëve sipas detyrës zyrtare, pasi që natyra dhe kontesti i rasteve na pamundësojnë që të parashikojmë sesa avokat mund të angazhohen në raste të caktuara. Gjatë këtij viti është bërë kompensimi i një të burgosuri pa bazë në vlerë 120,000.00 €.

Naser Osmani u interesua për mundësinë e ekzistimit të një çmimore e avokatëve për shërbimin të cilin e bëjnë?

Enver Peci sqaroj se avokatët e kanë çmimoren e tyre, varësisht nga marrëveshja me Odën e Avokatëve një avokat sipas detyrës zyrtare brenda muajit mund të realizoj 500.00€.

Latif Gashi kërkoj sqarime nga drejtori për financa rreth 66 pozitave të paplotësuara duke pasur parasysh faktin se buxheti për kategorinë *Paga dhe Mëditje* është realizuar 95.58 %?

Hykmete Bajrami konstatoj se pozitat nuk janë plotësuar dhe buxheti është shpenzuar pothuajse 100 %, poashtu kam vërejtur se me vendimin 23/109 të Qeverisë ka pasur shkurtim prej 600,000.00 € në kategorinë *Paga dhe Mëditje* si dhe në bazë të një vendimi tjetër janë shkurtuar 155,000.00 € në kategorinë e *Mallrave dhe Shërbimeve* dhe 2,000.00 € në kategorinë e *Shpenzimeve Kapitale*. Duke pas parasysh faktin se jeni institucion i pavarur kërkoj sqarim rreth këtyre shkurtimeve buxhetore se a jeni të konsultuar nga Qeveria, a e ka hendikepuar ky shkurtim punën e juaj si dhe a cenohet pavarësia juaj nëse këto shkurtime nuk bëhen pa bashkëpunimin tuaj?

Vehbi Behluli sqaroj se arsyeja e shpenzimit në 95.58% nga kategoria *Paga dhe Mëditje* janë për shkak të shkurtimit prej 600,000.00 € si dhe pozitat e paplotësuara për gjyqtarë kanë qenë 66 duke pas parasyshpagën mesatare të tyre prej 1,000.00€. Kurse sa i përket shkurtimeve me vendime të Qeverisë në

si Këshill nuk njoftohemi përveç departamentit të buxhetit në Ministrinë e Financave të cilët na njoftoj për shkurtime.

Latif Gashi nga raportimi rezulton se këto shkurtime nuk e kanë penguar punën e Këshillit Gjyqësor ngase pozitat kanë qenë të paplotësuara, pra është mirë të saktësohet se shkurtime të cilat janë bërë nuk e kanë penguar funksionimin e këtij Këshilli.

Vehbi Behluli theksoj se shkurtime kanë ndodhur në gjastë mujorin e dytë pas rishikimit të buxhetit pas analizave të bëra se nuk mund të plotësohen pozitat.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë :

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012.

6. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012

Kryetarja theksoj se nga raporti financiar i AKP-së vërejmë se mjetet janë shpenzuar 74.55% si dhe të hyrat që gjeneron ky institucion janë prezantuar në raport.

Skender Komoni vlerësoj se gjatë vitit 2012 AKP ka mbajtur tre valë privatizimesh 54,55,56 dhe tetë shitje të aseteve me likuidim, procesi i likuidimit ka filluar për 173 ndërmarrje. Prezentoj raportin e AKP-së dhe shpenzimet sipas kategorive dhe ofrojë sqarimet për për nivelin e shpenzimeve të caktuara të përfshira për nënkategoritë ekonomike.

Latif Gashi vlerësoj se raporti teknikisht është në rregull dhe plotëson të gjitha kushtet ligjore për miratim, vlen të theksohen shpenzimet e vogla tek *Mallrat dhe Shërbimet* në raport me vitin paraprak. Pse është një përqindje kaq e vogël e shpenzimit të kësaj kategorie?

Shkelzen Lluka sqaroj se zhvillimet buxhetore në vitin 2012 tregojnë se në raport të shpenzimeve kemi prej 75% të buxhetit krahasuar me vitin 2010 dhe 2011. Arsyeja e mos shpenzimit lidhen me mungesën e Bordit të Drejtorëve, buxheti për programin e auditimit i cili nuk është shpenzuar në tërësi për shkak të çmimit të ofruar për vlerësimin e ndërmarrjeve shoqërore ka qenë më i ulët nga ai që është paraparë. Buxheti për programin e Departamentit Ligjor nuk është shpenzuar në tërësi për shkak të varësisë nga rastet apo kontekstet gjyqësore që mund të rrjedhin, programi për organizimin e riorganizimit dhe administrimit të ndërmarrjeve shoqërore ka pasur ngecje për shkak se njësia për riorganizimin e Trepçës është dashur të ketë aprovim të Bordit të Drejtorëve. Buxheti për programin e likuidimit ka qenë shumë i ulët për shkak të vonësave në përzgjedhjen e kompanisë për ofrimin e shërbimeve profesionale në likuidim.

Xhevdet Neziraj konsideroj se agjencioni ka një menaxhim të dobët sepse fondi i 20% është vonuar pa nevojë duke pas parasysh se agjencioni ska detyrë më primare sesa t'i shpërndaj këto mjete të cilat i takojnë punëtorëve. Poashtu kërkoj të informohemi lidhur kontratat të cilën e keni pasur me Snisen që është përfolur shumë te likuidimi, një kontratë për realizimin e shpenzimeve të cilën e ka paraqitur raporti i zyrës së auditorit të përgjithshëm. Po ashtu komiteti i auditimit të brendshëm të jetë më funksional dhe vërejtjet që paraqiten të mos përsëriten nga Agjencia.

Shkelzen Lluka sqaroi se për 20% është e ditur që në bazë të ligjit të aplikueshëm në Kosovë AKP-ja nuk ka të drejtë të lejojë që mjetet të shpërndahen pa u miratuar lista e veçantë nga Oda e Gjykatës Supreme. Mendoj se adresa dhe fajësimi i agjencionit për këtë rast është e gabueshme. Në bazë të analizës së Bordit të atëhershëm është marrë një vendim që të përpilohet një strategji për ndarje përkohshme të 20%. Strategji kjo e cila nuk pret miratimin e Odës së Gjykatës Supreme për t'i ndarë mjetet, 75% për punëtorët e ligjshëm. Gjatë mbledhjes së fundit të Bordit është amendamentuar kjo strategji duke bërë shpërndarjen deri në 90% për punëtorë të ligjshëm çdo herë pa i prekur vendimet përfundimtare të kësaj Gjykate. Sa i përket gjetjeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm lidhur me autoritetin e likuidimit nuk pajtohem aspak sepse kjo zyre thotë se AKP-ja mjetet për kryerjen e likuidimit të një ndërmarrje duhet t'i shfrytëzoj pasi të përfundoj likuidimi i asaj ndërmarrje kurse mjetet në avancë t'i dërgojë nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Hykmete Bajrami pajtohem lidhur me aprovimin e listave por konsideroj se ju si udhëheqës të institucioneve keni detyrë që të trokisni tek legjislativi dhe qeveria për të iniciuar ndryshimin e ligjeve të cilat paraqesin pengesë për përfundimin e punës suaj. Është e njohur që punëtorët shumë herë protestojnë para dyerve tuaja prandaj pyetjet e ngushta lidhur me ligjet duhet të i tregoni dhe jo vetëm të arsyetoheni kur merrni akuza se punët nuk po përfundojnë me kohë.

Shkelzen Lluka konstatoj se çështja e 20% është njëra nga çështjet për të cilat agjencioni duhet të lavdërohet. Kemi zhvilluar takime me Ministrin e Drejtësisë për shkak të ankesave të Gjykatës lidhur me ndërrimin e shpesh të gjyqtarëve të Eulex-it duke i lënë pozitë e hapura pezull për arsye të procedurave të votimit të tyre. Përkundër takimeve të shumta nuk është e jona që të ndërhyjmë por është përgjegjësi e Këshillit Gjyqësorë dhe Gjykata Supreme.

Me nëntë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Latif Gashi, Jelena Bontic, Duda Balje, Hykmete Bajrami, Xhevdet Neziraj, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj) një abstenim (Albana Fetoshi) dhe asnjë votë kundër, Komisioni nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012.

7. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit vlerësues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së

Kryetarja theksoj se Banka Qendrore sipas legjislacionit në fuqi nenit 38.2 ka respektuar të gjitha procedurat për përzgjedhjen e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore. Nga biografitë e kandidatëve të propozuar, shihet se i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e domosdoshme të parapara me nenin 40 të Ligjit të BQK-së.

Latif Gashi u interesua rreth mundësisë që Komisioni a mundet të rekomandoj më pak kandidatë për votim?

Kryetarja theksoj se nuk kemi bazë ligjore për të eliminuar ndonjërin nga kandidatët e propozuar dhe ne vetëm vlerësojmë plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore, gjë që shihet se të gjithë kandidatët i pëmbushin kushtet e domosdoshme.

Pas diskutimeve, Komisioni, njëzëri nxorri këtë :

Rekomandim

1. I rekomandon Kuvendit, të përzgjedhë njërin prej kandidatëve për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, si në vijim:

**Sejdi Rexhepi,
Driton Balaj,
Enver Krasniqi,
Ramë Rexha.**

2. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, t'i dërgohet Presidentes për miratim dhe emërim në pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

8. Të ndryshme

Kryetarja njoftoj lidhur me dy ftesat të cilat kanë ardhur, njëra është për organizimin e një punëtorie të cilën e organizon zyra e Bankës Botërore në bashkëpunim me Shoqatën e Kontabilistëve të Kosovës. Janë të ftuar gjithë anëtarët e Komisionit, temë e këtij takimi është: *Ligji për Kontabilitet dhe Raportim Financiar*. Ftesa tjetër është nga Ministria e Financave për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore për vitin 2014. Poashtu kërkoj nga grupi punues lidhur me monitorimin e ligjit për prokurim publik që të përfundojnë punën si dhe grupi punues që ka të bëjë me monitorimin e ligjit për lojërat e fatit të filloj punën.

Naser Osmani konsideroj se nuk duhet të marrim pjesë në grupet punuese të cilat bëjnë ndryshimin e ligjit i cili pastaj vie tek ne duke na sjell në situatë jo të mirë.

Latif Gashi vlerësoj se nuk është e drejtë të marrim pjesë në grupe punuese për arsye se po i njëjti plotësim ndryshim vie prapë tek ne.

Mbledhja përfundoi: 12:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj